Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY
RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES **87-22**

Visar BIBAJ – Exp. Shqyrtues	***Data e autorizimit të ekspertit 05.04.2022***	***Data e dorëzimit të raportit 13.04.2022***

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 04.04.2022, OE "AS Tech"shpk - Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: **89/22**, kundër ri propozimit per dhënie te kontrates, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Furnizimi dhe servisimi i kondicionerëve te ME-se**", me numer të prokurimit: **213-21-4263-1-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Ekonomisë.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 15,000.00€.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2. PRETENDIMET ANKIMORE

DISPOZITAT E LPP-se, TE SHKELURA NGA AK SIPAS OE ANKUES

Neni 7, 59 dhe 60.

DEKLARATA NE ANKESE

Eshte shume befasues dërgimi i Vendimit te ri te AK duke e ditur se lënda eshte ende ne OSHP dhe nuk eshte marr asnjë vendim per shkak te mungesës se bordit te OSHP- se.
Nga shkeljet qe janë bere nga vlerësimi i kaluar ne si OE i eleminuar nga pakënaqësia kemi derguar lenden ne OSHP.
Lënda eshte vlerësuar nga eksperti shqyrtues i prokurimit i cili duke e vlerësuar si te bazuar propozon kthimin e lendes ne rivlerësim. Mendimi i eksperti sado ne favor te kompanisë dhe ankese tone eshte vetëm nje mendim dhe vlerësim i lendes por qe lëndaende eshte ne pezullim deri sa bordi i OSHP-se te merr ndonjë

vendim. Pra lënda eshtene proces, ashtu siq shihet ne web te OSHP-se**(Statusi i ankesës: Ne Proces).**

Prandaj nuk e din ku e merr AK te drejtën qe lenden ta vazhdoni me rivlerësim kur dihet se ajo aktualisht eshte pezulluar, ky veprim eshte mungese respekti per legjitimitetin e OSHP-se nga ana e AK-se.

Jemi ne dijeni se po detyrohemi te bëjmë kete ankese meqenëse Ak fillimisht e morri vendimin e pavend duke e ditur se lënda eshte ende ne OSHP.

Bashkangjitur kësaj kerkese per rishqyrtim eshte edhe mendimi i ekspertit me nr. 639- 21 i datës 18.10.2021. ndërsa me poshtë gjeni te shkëputur mendimin përfundimtar e ekspertit shqyrtues per kete lendezi i aates is.iu.zuzi. naersa me posnte gjeni te snKeputur menaimin periunaimtar e ekspertit shqyrtues P£tkgjç,lende.

8. MENDEVfl IEKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqariinet e lartpërmendura. eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE AS Të.çh ?hpk - Prishtinë, te aprovohet si e bazuar. te anulohet propozimi për dhënie te kontratës dhe lënda te kthehet ne Ri - Vlerësini.

Ne vendimin e saj AK shpall OE te papërgjegjshëm per kontrate, nga qasja qe kemi pasur ne procesin paraprak te vlerësimit kemi vërejtur disa mangësi te ofertës se OE Alfai.
OE i rekomanduar per kontrate ka kontrata vetëm per furnizime dhe jo edhe per servisime ashtu siq eshte kërkuar ne dosje, prandaj smund te cilësohet oferte e përgjegjshme.
Nuk e ka ne oferte FDT-ne qe eshte kusht.
*Nuk e ka nënshkruar dhe vulosur paramase, identifikimin financiar*Nuk ka autorizim per nënshkrim te te dokumenteve personi qe i ka nënshkruar, askund nuk ka vendim tek noteri me ate emër.

Kerkojme nga OSHP kthimin e lendes ne rivlerësim dhe rekomandimin e AS Tech SH.P.K. per dhenje te kontratës

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:
Kërkesa 1. OE- duhet të ofroj dëshmi të mjaftueshme se ka realizuar projekte të ngjashme në tri vitet e fundit nga data e njoftimit per kontrat në vlerë minimale 20,000.00 €.
Dëshmia e kërkuar dokumentare
1.Për kërkesën 1. Lista e kontratave të realizuara në tre vitet e fundit para dates se njoftimit per kontrat për shërbime - (të ngjashme) të dëshmohet me referencë pozitive, apo raporte te pranimit teknik në vlerë min (20,000.00 €).

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Ministria e Ekonomise shpërblen me kontrate OE ALFA ne vlere totale prej 14,440.25€

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

NA

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

NA

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues / Ministria e Ekonomisë**,** gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur me vlere te mesme, lloji i kontratës është shërbim me vlere te mesme.

Kjo procedure e prokurimit ka qene objekt shqyrtimi ne OSHP, përkatësisht ekziston raporti i ekspertizës me numër **639/21**, ku ishte kontestuar arsyetimi i eliminimit atëherë. AK – Ministria e Ekonomisë, ka ri vlerësuar ofertat dhe ka ri rekomanduar për dhënie te kontratës operatorin e njëjte ekonomik, përderisa parashtruesin e ankesës e ka eliminuar por me arsyetim tjetër.

- Po ti referohemi te dhënave te ngarkuara ne e-prokurim kundrejt këtij aktiviteti te prokurimit rezulton qe AK ME, fillimisht me datën 31.08.2021, e ka pezulluar ketë aktivitet te prokurimit. Sipas nenit 112, te LPP-se autoritet për heqje te pezullimit ka vetëm Kryetari i OSHP-se dhe atë pas kërkesës se AK-se, një krekës e tille nuk është bere nga AK – ME, megjithatë edhe me datën 05.04.2022, përsëri është pezulluar aktiviteti i prokurimit.

Përgjigjeje në pretendimin ankimore (neni 113): Dispozitat e nenit **111**, te LPP-se përcaktojnë kushtet kur një ankese duhet te pranohet dhe te trajtohet ne OSHP, situata si kjo e trajtimit te ankesës se dyfishte apo pa një vendim paraprak nuk është e zakonshme, megjithatë kemi pranuar autorizim për ti trajtuar pretendimet ankimore, përkundër faktit se pas pezullimit fillestar i procedurës është bere rreth 5 muaj me pare!

- Edhe parashtruesi i ankesës i konteston veprimet e AK-se, i njëjti thirret edhe ne ueb faqe te OSHP-se, ku për te njëjtin aktivitet te prokurimit sipas ueb faqes thuhet se ende është ne proces te vendim marrjes. Tani kontestohet përgjegjshmëria e operatorit ekonomik te ri rekomanduar për dhënie te kontratës , kontestohen kontratat e prezantuara si te realizuara, potencohet se, nuk është vulosur dhe nënshkruar oferta financiare dhe nuk është oferta e dorëzuar nuk është dorëzuar nga personat përgjegjës.

- Sipas shkresave te lendes dhe ofertës se OE te ri rekomanduar për dhënie te kontratës rezulton qe i njëjti ka prezantuar autorizim për personin qe ka dorëzuar oferte nga personi përgjegjës i kompanisë, oferta financiare është pjese e ofertës dhe mos nënshkrimi i saje nuk e bene ofertën e pa përgjegjshme, po ashtu edhe projektet e prezantuara, përkatësisht dështmitë për projekte e mbulojnë kërkesën e AK-se. Janë kërkuar projekte te ngjashme dhe jo te njëjta siç pretendohet nga parashtruesi i ankesës.

Megjithatë, po ti referohemi arsyetimit te eliminimit te operatorit ekonomik ankues rezulton qe AK – ME, ka dhëne arsyetime te cilat bien ndesh me dispozita ligjore ne përgjithësi, rrjedhimisht është potencuar se sigurimi i ofertës është ofruar pas skadimit te saje dhe është thirre ne dispozita ligjore ku flasin për obligime te AK-se, jo te OE-se (*pyetjet e shpeshta te publikuara nga KRPP-se, ku flet për obligimet e AK-se qe (nuk* ***mund te kërkohet*** *zgjatja e validitetit te ofertave ne mënyre retroaktive*). Parashtruesi i ankesës ne rastin e ankimimit posedon sigurim te tenderit për periudhën nga data 20.12.2021 deri me datën 20.04.2022. Po ashtu parashtruesi i ankesës ka prezantuar liste te gjate te projekteve si te realizuara por AK – ME, e ka eliminuar dhe nuk i ka kërkuar dështmitë – referencat siç përcaktohet me dispozitat e nenit **39**, te RrUOPP-se, rrjedhimisht ofertuesit nuk janë trajtuar ne mënyre te barabarte siç parashihet me dispozitat e nenit 7, te LPP-se.

Si prove se bashku me raport gjeni kopjet:

Deklarata e garantuesit – sigurimi i Tenderit ne emër te OE ankues

Autorizimi i OE te ri rekomanduar për dhënie te kontratës

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE AS Tech shpk – Prishtinë, te aprovohet si pjesërisht **e bazuar**, të anulohet propozimi për dhënie te kontratës dhe lënda te kthehet ne **Ri – Vlerësim,** me qellim te pasqyrohet gjendja reale e ofertave kundrejt kërkesave duke i respektuar dispozitat ligjore dhe parimet e LPP-se.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – Ministria e Ekonomisë.
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues - AS Tech shpk - Prishtinë.